



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.5/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaçi dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Valbona Millaku - Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, (BIRN dhe IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme, të mbajtura me datë 19.05.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.05.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET poshtë ankesa e Rrjetit Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, që identifikohet ne panel me shenjën Anr.5/2019 e datës 20.05.2019.

A r s y e t i m

Me datën 20.05.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe IKS, me të cilën ka pretenduar se në Qendrën e Votimit 2802/b Shkolla “Jovan Cviq”, në Komunën e Zubin Potokut, kanë votuar votues me dokumente jo të vlefshme dhe me dokumente te Serbisë. Me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar pasi që ka pas parregullsi bazuar sipas parashtruesit të ankesës ne nenin 90 të LZP-së.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e BIRN dhe Internews Kosova është e parregullt, sepse parashtruesi i ankesës nuk e ka përshkruar se kush janë votuesit që kanë votuar në Qendrën e Votimit lëndor, te cilët kanë votuar me dokumente te pa vlefshme dhe me dokumente te Serbisë. Për këtë çështje paneli kishte kërkuar nga parashtruesi i ankesës plotësimin e saj, sipas parashtresës së panelit të datës 20.05.2019, mirëpo parashtruesi i ankesës me përgjigje në ankesë nëpërmes postës elektronike ka theksuar se nuk kanë mundësi objektive që ta bëjnë plotësimin e ankesës.

Paneli vlerësoi pretendimet e parashtruesit të ankesës se nuk kanë pas mundësi objektive për ta plotësuar ankesën por konsideron se duke marr parasysh faktin se parashtruesi i ankesës në ditën e votimit, ka pasur te akredituar vëzhguesit dhe qëllimi i akreditimit ka qenë të bëjë vëzhgimin e zgjedhjeve dhe evidentimin e shkeljeve eventuale, në rastin konkret është dashtë që te merren te gjitha të dhënat e nevojshëm për shkeljet eventuale. Poashtu nga të dhënat të cilat i përmban ankesa nuk ka të dhëna as sa persona kanë votuar me dokumente të pa vlefshme apo me dokumente te Serbisë, e që ankesën e bënë e pa plotë.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat, ligjore te nenit 5 paragrafi 7 dhe neni 6 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it 02/2015.

Nga arsyet e lartcekura, dhe duke u bazuar nenin 5 paragrafi 7, nenit 6 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.5/2019 më datën 20.05.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*